

VENDIM
Nr. 36/2025

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT SIMON MIRAKAJ ANËTAR TË BORDIT TË
INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË
SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Institutit të Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Simon Mirakaj zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 17.3.2025.